



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 895/2019
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg. 22105119
Data/Datum/Date:



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIM I AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr. 542/2018
Organizata Joqeveritare “Iniciativa për Progres-INPO”
kundër

Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë

lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Drejtuar: Z. Ekrem Kastrati, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Kopje: Z. Shyqiri Bytyçi, Ministër
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Prishtinë, më 27 maj 2019

Qëllimi i Raportit

1. Qëllim i këtij rapporti është identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga autoritetet përgjegjëse lidhur me ankesën e Organizatës Joqeveritare “Iniciativa për Progres-INPO” (në tekstin e mëtejmë: INPO) për qasje në dokumente publike parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MAShT); analizimin e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) përkizati me ankesën në fjalë; si dhe identifikimin e detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkuesave për qasje në dokumente publike. Raporti bazohet në faktet, provat, si dhe nga shkresat e lëndës, të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP).

Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
3. Gjithashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 18, paragrafi 1, përcakton se Avokati i Popullit, mes tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:
 - “*Të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre.*” (Pika 1).
 - “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë.*” (Pika 2).
 - “*Të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritisës së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave.*” (Pika 4).
 - “*Të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (Pika 5).
 - “*T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Pika 6).
 - “*Të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.*” (Pika 8).

Me dërgimin e këtij rapporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t'i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i çështjes

Dëshmitë dhe informatat të cilat i ka IAP-ja, të ofruara nga ankuesi dhe të evidentuara nga hetimi i bërë lidhur me rastin, përmblidhen si në vijim:

4. Më 17 korrik 2018, INPO-ja, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar udhëheqëses së Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it me kërkesë për qasje në vlerësimet e ligjshmërisë së akteve normative nga fusha e arsimit, e shkencës dhe e teknologjisë, që MASHT-i i ka punuar gjatë vitit 2017, si dhe për periudhën janar - qershor 2018.
5. Më 1 gusht 2018, INPO-ja, nëpërmjet postës elektronike, e kishte përsëritur kërkesën për qasje në vlerësimet e ligjshmërisë së akteve normative nga fusha e arsimit, e shkencës dhe e teknologjisë që MASHT-i i ka punuar gjatë vitit 2017, si dhe për periudhën janar - qershor 2018.
6. Më 6 gusht 2018, bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), INPO-ja kishte parashtruar ankesë në IAP kundër MASHT-it për mospërgjigje në kërkesën për qasjes në dokumente publike.
7. Më 13 gusht 2019, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me shkresë Sekretarit të Përgjithshëm në MASHT, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar informata lidhur me veprimet që ishin ndërmarrë dhe ato që planifikoheshin të ndërmerren lidhur me kërkesën e INPO-s. Meqenëse Avokati i Popullit nuk kishte marrë përgjigje në këtë shkresë, më 30 tetor 2018, i është drejtuar përsëri me shkresë Sekretarit të Përgjithshëm në MASHT, por as në këtë shkresë nuk ka marrë përgjigje.
8. Më 15 nëntor 2018, IAP-ja, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar udhëheqëses së Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it, përkitazi me ankesën e INPO-së, por nuk ka marrë përgjigje.
9. Më 19 nëntor 2018, përfaqësuesja e IAP-së është takuar me udhëheqësen e Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it, me ç' rast ajo ka pohuar se janë në përgatitje të përgjigjes për Avokatin e Popullit dhe për INPO-n. Meqenëse përfaqësuesja e IAP-së nuk ka pranuar përgjigje, por as INPO-ja, më 6 dhjetor dhe më 24 dhjetor 2018, nëpërmjet postës elektronike, ajo i është drejtuar udhëheqëses së Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it, përkitazi me ankesën e INPO-s, por nuk ka marrë përgjigje.
10. Më 16 janar 2019, përfaqësuesja e IAP-së ka kontaktuar me udhëheqësen e Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it, lidhur me çështjen në fjalë, e cila ka pohuar se është në pritje të përgjigjes nga zyra ligjore në MASHT dhe, posa ta ketë këtë përgjigje, do ta përcjellë te INPO-ja.
11. Më 7 shkurt 2019, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet postës elektronike, ka pranuar një përgjigje nga udhëheqësja e Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it. Të njëjtën përgjigje e ka pranuar edhe INPO-ja. Në këtë përgjigje, MASHT-i i ka listuar dokumentet për të cilat e ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë, por nuk i ka dërguar dokumentet.

12. Më 11 mars 2019, përfaqësuesja e IAP-së, nëpërmjet postës elektronikës, iu drejtua udhëheqëses së Divisionit për Komunikim me Publikun e MASHT-it, duke kërkuar që INPO-s t'i përcillen dokumentet e kërkuar, të cilat, në përgjigjen e dërguar nëpërmjet postës elektronike, janë listuar si dokumente për të cilat është kërkuar vlerësimi i ligjshmërisë nga MASHT-i, por nuk mori përgjigje.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë

13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 41, parografi 1, parashevë të drejtën për qasje në dokumente publike, ku definohet: “*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*”
14. Parografi 2 i po të njëjtët nen të Kushtetutës përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet janë të qasshme për të gjithë, me përjashtim të atyre dokumenteve qasja e të cilave është e kufizuar me ligj: “*Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*”
15. E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, nen 19 i së cilës përcakton: “*Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.*”
16. Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parashevë edhe nen 10, parografi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: “*Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...*”
17. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: “*Ky ligj garanton të drejtën e seclit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuara nga institucionet publike.*”
18. Neni 7, parografi 8, i LQDP-së thekson shprehimi: “*Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetur refuzimin e plotë apo të pjesëritshëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkeze për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.*”
19. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke trajtuar parimin e administratës së hapur, në nenin 9, parografi 1, parashevë: “*Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.*”

Analiza e rastit dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

20. Avokati i Popullit vëren se kërkesa e INPO-s për qasje në dokumente publike, e datës 17 korrik 2018, drejtar MASHT-it, ka të bëjë me qasje në vlerësimet e ligjshmërisë së akteve normative nga fusha e arsimit, e shkencës dhe e teknologjisë, të cilat MASHT-i i ka punuar gjatë vitit 2017, si dhe për periudhën janar - qershor 2018, dokumente këto që nuk bëjnë pjesë tek përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente publike, siç është përcaktuar në nenin 12 të LQDP-së.
21. Nga hetimet përkitazi me ankesën e INPO-s, Avokati i Popullit konstaton se MASHT-i fare nuk është përgjigjur në kërkesën e parashtruar për qasje në dokumente publike, që bie në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 8, të LQDP-së, sipas të cilit, institucioni publik obligohet që të nxjerrë vendim brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës. Për më tepër, MASHT-i, përveç që ka dështuar të përgjigjet në kërkesën e INPO-s për qasje në dokumente publike, dokumente këto që nuk kufizohen me LQDP, ka dështuar edhe të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit. Prandaj, Avokati i Popullit ia rikujton MASHT-it detyrimin ligjor që rrjedh nga neni 25 i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.
22. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së, që sipas nenit 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. GjEDNj-ja, në aktgjykimin për rastin *Observer And Guardian V. The United Kingdom*, theksion: “*T'i mohosh publikut informacione mbi funksiononim e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.*”¹
23. Më tej, GjEDNj-ja, në rastin *Stell and Morris v The United Kingdom*, i datës 15 maj 2005, ndër të tjera, e konsideron se në një shoqëri demokratike edhe grupet e vogla dhe ato joformale duhet të jenë në gjendje t'i kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë efektive dhe se ekziston një interes i fortë publik që ua mundëson grupeve dhe individëve të jashtëm që të kontribuojnë në debatin publik, duke dhënë informacione me interes të përgjithshëm (paragrafi 89).²
24. Nisur nga sa u tha më lart dhe me qëllim të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, si dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënieς, si dhe në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, Avokati i Popullit i:

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë

1. T'i ofrojë Organizatës Joqeveritare “Iniciativa për Progres-INPO” qasje në dokumentet e kërkuar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i*

¹ Case Of *Observer And Guardian V. The United Kingdom*, (*Application no.13585/88*, 26 November 1991)

² Rasti *Stell and Morris v The United Kingdom*, (*Aplikimi nr. 68416/01*, 15 maj 2005).

detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj") dhe me ninen 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit